



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
Mbledhja nr. 17
Prishtinë, më 15 korrik 2013, në orën 11:00, sala S-II
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR MBIKËQYRJEN E FINANCEVE PUBLIKE

Në mbledhje morën pjesë: Ali Sadriu, Ramiz Lladrovci, Mursel Haljilji, Valbona Dibra, Imri Ahmeti, Adem Grabovci, Afrim Hoti, Bali Muharremaj dhe Albert Kinolli.

Të ftuar: Rrahman Paçarizi, kryetar Bordi në RTK, Mentor Shala, drejtor i përgjithshëm i RTK-së dhe Lars Lage Olofsson, auditor i përgjithshëm.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Fatime Qorri, koordinatore e Komisionit, Mehmet Simnica, zyrtar i fushës për ekonomi dhe Saranda Kelmendi, praktikante.

Mbledhjen e kryesoi: Ali Sadriu, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. **Miratimi i rendit të ditës;**
3. **Shqyrtimi i raportit vjetor të Radiotelevizionit të Kosovës për vitin 2012;**
4. **Të ndryshme.**

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, njëzëri, miratoi rendin e ditës me ndryshimet e propozuara nga kryetari.

2. Shqyrtimi i raportit vjetor të Radiotelevizionit të Kosovës për vitin 2012

Kryetari – Çështja e mos prezencës së drejtorit të përgjithshëm të RTK-së, në mbledhje të Komisionit është ngritur në media gjoja që Bordi i RTK-së është injoruar nga Komisioni. Kjo nuk qëndron, sepse injorimi vije nga drejtori në raport me Komisionin. Raporti vjetor i RTK-së është nënshkruar nga drejtori menaxhues, pastaj letra e menaxhmentit, po ashtu është e nënshkruar nga drejtori menaxhues. Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, në vazhdimësi ka përcjellë menaxhimin e RTK-së dhe në bashkëpunim me Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm ka nxjerrë rekomandime për RTK-në, për adresim të çështjeve. Është brengose që edhe pse drejtorit të përgjithshëm të RTK-së i është dorëzuar ftesa për pjesëmarrje në Komision me kohë, datë 27 qershor 2013, në orën 10:15, ai nuk ka kthyer kurrfarë përgjigje për mospjesëmarrjen e tij, por qëndrimin e tij e ka bërë publik në mbrëmje, në lajmet e orës 19:30, përmes televizionit të cilin e ka nën menaxhim. Ndërsa, njoftimin zyrtar, Komisioni e ka pranuar më 03 korrik 2013. Komisioni ka vërtetuar se njoftimi për Kuvendin nga RTK-ja është bërë më 02 korrik 2013, në orën 09:50, kohë kjo kur Komisioni kishte nxjerrë përfundimin që takimi të shtyhet për një datë tjetër. Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike është ai i cili vendos për zyrtarin që do të ftojë në mbledhje të Komisionit. Këtë e bën për të pasur të pranishëm personat që mund të japin informata të plota për institucionin. Në rastin konkret Komisioni ka vlerësuar se drejtori i përgjithshëm është personi përgjegjës për arsyetimin e Raportit. Komisioni ka bërë një komunikatë për shtyp që për çudi mediat nuk janë marrë me të. Në bazë të nenit 62, të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 20 korrik 2011, Komisioni ka shqyrtuar Raportin e auditimit të pasqyrave vjetore financiare të RTK-së për vitin 2010. Në mbledhjen plenare, të datës 29 korrik 2011, është miratuar Raporti me rekomandime i Komisionit, sipas të cilit është obliguar RTK-ja që në afatin prej tre muajve, të ndërmarrë veprime konkrete lidhur me të gjitha të gjeturat e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm dhe lidhur me këtë ta njoftojë Kuvendin, përmes Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, me raport me shkrim. RTK nuk i është përgjigjur kërkesë së Kuvendit. Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, ka insistuar që RTK, të dorëzojë në Kuvend raport me shkrim në bazë të Vendimit të Kuvendit, Nr. 04-V-147, më 29 korrik 2011. Më 15 maj 2012, me propozim të Kryetarit të Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, është shtyrë shqyrtimi i Raportit vjetor të RTK-së, me qëllim që në Kuvend të procedohet edhe raporti sipas Vendimit të Kuvendit. Komisioni me kërkesë të veçantë ka kërkuar nga RTK-ja përmbushjen e Vendimit të Kuvendit, por përsëri nuk ka marrë përgjigje. Me Përfundimin e Kryesisë së Kuvendit Nr. 04-P-130/k, datë 28 janar 2013, është kërkuar nga RTK-ja që brenda afatit prej 15 ditësh të dorëzojë Raportin lidhur me të gjeturat e ZAP-it, sipas kërkesës së Kuvendit. Më 25.02.2013, RTK ka dorëzuar planin e veprimtimit në Komisionin për Mbikëqyrje të Financave Publike të Kuvendit, së bashku me hapat e ndërmarrë për adresim për secilin rekomandim.

RTK ka bërë përzgjedhjen e auditorit të jashtëm për auditimin e pasqyrave vjetore financiare. Ka pasur bazë ligjore lidhur me këtë, por kjo për Komisionin përbën konflikt interesi dhe bazuar në këtë Komisioni do të rekomandojë ndryshimin e këtij ligji. Sipas raportit të auditorit të pavarur opinioni për RTK-në është i kualifikuar dhe janë dhënë tri rekomandime shumë serioze rreth regjistrimit të pasurisë, si dhe në mungesë të listës së plotë të aseteve dhe vendndodhjes së tyre, paditë ndaj RTK-së nga OE dhe për shkak të mos pagesës së borxheve nga RTK-ja. Pra ka mospërputhje të borxheve të papaguara në pasqyrat vjetore financiare nga viti në vit. Hap diskutimin.

Ramiz Lladrovci - Para se Komisioni të hyjë shqyrtim të raportit, kërkoi raport nga drejtori i përgjithshëm se pse ka injoruar ftesën e Komisionit për pjesëmarrje në mbledhje?

Mentor Shala, RTK – Mos prezenca e drejtorit menaxhues nuk ka qenë injorim, por pas konsultimit me kryetarin e bordit, ne kemi vlerësuar se në këtë rast është injoruar bordi. Më tepër këtë e kam marrë si moskuptim dhe ne jemi të gatshëm për raportim. Nëse e keni marrë si

injorim kërkoi falje, por ka qenë thjesht një keqkuptim.

Valbona Dibra- Komisioni po shqyrton raportin vjetor të punës me raportin e auditorit të pavarur i cili ka dhënë një opinion të kualifikuar. Me ndryshimin Ligjit për RTK-në është hequr e drejta e auditorit të përgjithshëm për auditim të RTK-së. Personalisht kam propozuar që të ndryshohet ky ligj, sepse ZAP duhet të ketë qasje për auditim në RTK. Kjo për faktin se RTK financohet nga buxheti i Kosovës, është përgjegjës para Kuvendit dhe është shumë e logjikshme që auditimin ta bëjë ZAP. Kjo jo me arsyetimin që ne jemi të pakënaqur me punën e një auditori të pavarur, por do të jetë më transparente dhe një mënyrë e kontrollit më të mirë për shfrytëzimin e parasë publike para taksapaguesve të Kosovës. Raporti ka paraqitur në detaje punën e këtij mediumi, i cili është në një krizë financiare që nga viti 2012, që nga shkurtimet buxhetore që janë bërë në vitin 2012 në këtë medium. Është parë një angazhim për përmirësim të gjendjes dhe në këtë drejtim Kuvendi, KMFP dhe KBF ka shprehur gatishmëri për përkrahje këtij mediumi publik. Opinionin kualifikuar nuk është opinion i mirë, por nuk është edhe prej atyre më të këqijve. Impiantet dhe pajisjet e kompanisë nuk dihet vendndodhja e tyre dhe kompania është paditur disa here nga furnitorët për mos pagesës së borxheve. Kjo është ngritur edhe nga vetë Bordi, sepse kanë mbi 3 milionë borxhe, me ndryshimet e Ligjit për buxhet uroj që menaxhmenti i RTK-së të menaxhojë më mirë me mjetet e buxhetit të Kosovës të cilat i ka në dispozicion. Po ashtu shpresoj që RTK të bëjë përpjekje për të ngritur performancën e këtij mediumi, sepse është krijuar një opinion se RTK nuk po menaxhon si duhet me paratë publike. Po shpresoj që të mos ketë qenë mosmarrëveshje mos prezenca e drejtorit të RTK-së, sepse vitin e kaluar ne i kemi pasur të pranishëm përfaqësuesit e RTK-së, po shpresoj që të kemi bashkëpunim edhe në të ardhmen.

Afrim Hoti – Udhëheqësi i prokurimit për vite me radhë që është UD. Sipas LMFPP nëse një pozitë e zyrtarit financiar lirohet ajo duhet të plotësohet brenda 90 ditëve. RTK ka hapur procedurën e rekrutimit, por nuk e dimë nëse është përfunduar kjo procedurë. Në dy raste në pozitë ZKF dhe drejtori i administratës marrin pagë pa kontratë, kjo është në kundërshtim me Ligjin e punës. Gjatë periudhës së intervistimit Komisioni i intervistimit nuk mban procesverbal individual të poentimit gjatë intervistimit, por këtë e bëjnë mbasi të përfundojë intervista. Kjo për mendimin tim është kundërligjore.

Rrahman Paçarizi – Arsyeja e mospjesëmarrjes në mbledhje të Komisionit ka qenë sepse është hera e parë që është ftuar menaxhmenti pa praninë e Bordit. Bordi i përgjigjet Kuvendit, ndërsa menaxhmenti i përgjigjet Bordit. Plani aksionar i veprimit është bërë nga drejtori i përgjithshëm me një vonesë të konsiderueshme. Bordi ka qenë pa kuorum dhe shumë vendime nuk kanë mundur të merren. Janë probleme të trashëguara, borxhi nuk është rritur dhe menaxhimi i parasë publike ka qenë i mirë, por problemet kryesisht janë me përshtatjen e RTK-së me format e reja të raportimit, pra me futjen e financimit të RTK-së direkt nga buxheti i shtetit. Tri vërejtje sado serioze të jenë, janë me pak se 9, sa kanë qenë. Çështja e mungesë së kontratave është tejkaluar. Bordi ka kërkuar nga menaxhmenti që të shpall konkursi për drejtor të prokurimit dhe kjo çështje është në procedurë. Organogrami i RTK-së ka qenë një absurd sipas të cilit auditori i brendshëm i është përgjigj drejtorit. Pas ndryshimit të organogramit auditori i përgjigjet Bordit dhe tani kemi edhe Komisionin e auditimit i cili tashmë është funksional.

Kryetari - Është e drejtë e Komisionit të ftojë këdo në mbledhje për të sqaruar interesimet e Komisionit. Kam vërejtur që RTK ka vetëm një auditor të brendshëm. Rregullat për përcaktim të auditorëve janë 50 punëtorë, ose 1 milion euro. RTK ka mbi 600 punëtorë çka d.m.th. që RTK duhet të ketë një ekip të plotë të auditorëve. Pse po ndodh kjo?

Ramiz Lladrovci – Edhe në raport të auditorit edhe në raporte të tjera kemi parë që RTK ka një auditor. Auditori i brendshëm është i pavarur, por shqetësuese është që auditori i

brendshëm i RTK-së nuk ka asnjë plan të auditimit për 5 vjet të funksionimit të tij, asnjë plan të punës nuk ka bërë. Këtë është dashur ta përmirësoj Bordi dhe të ndërmarr masa urgjente që auditori i brendshëm, ose të kryej punën, ose të largohet. Auditori i brendshëm duhet të jetë i pavarur, por gjithsesi duhet të funksionojë dhe t'i përgjigjet Bordit. Pyeti: në vitin 2011 keni hyrë në borxhe pa planifikim. Keni hyrë në kontrata me OE pa mbulesë! Si do të dilni nga kjo gjendje? Planifikimi bëhet sipas buxhetit që keni, jo mbi bazën e nevojave.

Kryetari – Lidhur me borxhet nuk mund të hyjë në obligime kontraktuale pa zotime të mjeteve. Shkurtime buxhetore ndodhin në ato pozicione kur kalon afati për përdorimin e atyre mjeteve dhe në ato raste ndërhyjnë MF-ja, për bartje. Me përgjigjen me PV nuk jemi të kënaqur, ai plan është më shumë përshkrues dhe ne jemi të interesuar të kemi veprime konkrete.

Murselj Haljilji – Nga përgjigja për mospjesëmarrje në mbledhje të Komisionit kuptova që ju nuk e keni kuptuar se pse Komisioni ka ftuar drejtorin e përgjithshëm dhe jo kryetarin e Bordit. Është dashur të na drejtoheni me shkresë dhe nuk do të kishte një situatë të tillë. Keni pasur probleme me Bordin, sepse nuk keni pasur kuorumin për shumë vendime që është dashur të merren. Keni mbajt emisione dhe cilësia e tyre është e mirë. Por çështja e borxheve është shumë serioze. Janë disa padi kundër RTK-së lidhur me disa emisione për shkelje të të drejtave. Pastaj janë dhënë 140 shpërblime për stimulime në punë. Më intereson të di si Bordi nga shtatori ka marrë këtë vendim dhe kush është përgjegjës për shpërblime të tilla? A ka arsye që dikush të shpërblehet kur kompania është në këtë gjendje? Jam dakord që secili të marrë shpërblimin e merituar kur në kompani gjithçka të vihet në rend, por kjo duhet të bëhet duke marrë për bazë gjendjen në kompani.

Rrahman Paçarizi – Borxhi është bërë në tremujorin e parë ku ne kemi marrë të hyra nga Buxheti i Kosovës si për vitin 2010, mbi 2 milionë është bërë shkurtrim i buxhetit. Sa për planin drejtori i RTK ka bërë një plan për çështjen e borxheve.

Mentor Shala, RTK – Planifikimi është bërë në bazë të buxhetit të vitit 2010, sepse na është thënë që ashtu do të jetë edhe buxheti i vitit vijues. Pasi që është përmbushur një obligim ligjor që ka qenë hapja e konkursit për producent të jashtëm dhe kemi qenë të obliguar që 20% të ndajmë për producent të jashtëm. Pas lidhjes së kontratave në mars, ose prill është bërë shkurtimi i buxhetit. Në vitin 2013, kemi hyrë me 3.5 milionë euro borxhe. Puna e parë që është bërë është bërë një plan dinamik për kthimin e borxheve. Deri më tani 1.8 milion euro kemi arritur të kthejmë deri më tani. Nëse shkohet me këtë dinamikë, deri në fund të vitit do të kthejmë një pjesë të këtyre borxheve. Pastaj ne jemi medium publik dhe në raport me Unionin Evropian Transmetues gjithmonë shtohen borxhet, sepse në vazhdimësi vijnë materiale, pastaj kontratat për kampionate të ndryshme të sportit. Është hera e parë që auditori ka filluar me auditime në vitin 2013.

Paditë ndaj RTK-së, një kontest është zgjidhur në favor të RTK-së. Çështja e SIGMA-s dhe kompanisë së sigurimeve është në proces, sepse është ndërruar kompania e sigurimeve dhe ky proces është në procedurë. Çështja e shpërblimeve, me rregullore, drejtori i përgjithshëm ka të drejtë të shpërblejë punëtorët. Në atë kohë nuk kam qenë në këtë pozitë.

Imri Ahmeti – Rritja e borxheve është shqetësim për të gjithë ne. Të gjeturat janë të mëdha dhe sipas auditimit ka konstatime se ka probleme serioze në menaxhim. Pastaj në planin e veprimit nuk shohim ndonjë veprim konkret për kontroll të veçante të menaxhimit financiar. Drejtori i përgjithshëm tha se ka një plan dinamik për çështjen e borxheve, por nuk tha nëse ka një plan dinamik për fuqizimin e menaxhimit financiar dhe të kontrolleve. Kryetari i bordit justifikoj gjendjen me arsyen se ndërrimi i mënyrës së financimit të RTK-së ka sjellë RTK-në në këtë gjendje. Ky nuk duhet të jetë justifikim për disa të gjetura p.sh. pavarësisht mënyrës së financimit nuk ka pasur nevojë të rriten shpenzimet e telefonisë! Pastaj, nuk mund ta pranojmë

për justifikim që drejtori aktual ka marrë këtë pozitë tani 6 muaj, por do të duhej që të merreni me zgjidhjen e çështjeve.

Ramiz Lladrovci – Lidhur me borxhet e vitit 2011 tha se nuk ka shkurtime në muajin shkurt dhe mars, por atëherë është miratuar buxheti me vonesë për shkak të zgjedhjeve në Kosovë. RTK nuk mund të shpenzojë pa miratim të buxhetit. Në vitin 2012 RTK ka hyrë me borxhe, planifikimi bëhet me aq sa keni jo aq sa pritët të keni. Pastaj, mos adresimi i rekomandimeve është shumë serioze, sepse nga të gjitha rekomandimet RTK ka adresuar vetëm një, atë të përzgjedhjes së auditorit të jashtëm.

Sa kemi informacione pjesa e marketingut është shitur. I është dhënë një kompanie. Çka ka bërë RTK-ja me atë sektor? A është shuar, apo ku ka mbetur stafi i atij sektori?

Mentor Shala, RTK – Është e vërtetë që ai sektor i është dhënë një kompanie përmes një konkursi të hapur. Tani jemi në procedurë të negociatave për kontratë. Një pjesë e punëtorëve të asaj mbetet, sepse duhet të shërbejnë në monitorim të asaj kompanie. Një pjesë e tyre janë shpërndarë nëpër sektorë ku ka pasur nevojë.

Kryesuesi konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, njëzëri ka vendosur që Kuvendit t'i paraqes këtë

REKOMANDIM

1. Të miratohet Raporti Vjetor i Radiotelevizionit të Kosovës për vitin 2012.
2. Radiotelevizioni i Kosovës, në afatin prej tre muajve të dorëzojë Planin e veprimit për adresim të Rekomandimeve të dala nga raportet e auditimit.
3. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm të bëjë auditim të performancës së Radiotelevizionit të Kosovës.
4. Qeveria e Republikës së Kosovës, të marrë nismën për Ndryshimin edhe Plotësimin e Ligjit për RTK-në Nr. 04/L-046, lidhur me nenet që kanë të bëjnë me përzgjedhjen e auditorit të jashtëm për auditimin e RTK- së.
4. Arsyetimin e rekomandimit e paraqet deputeti Ali Sadriu, kryetar i Komisionit.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Ali Sadriu